



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD

**MIRATOHET
Z. BAJRAM PISHKASHI
SEKRETAR I PERGJITHSHEM**

DETYRË PROJEKTIMI
PËR HARTIMIN E PROJEKTIT

OBJEKTI: “STUDIM PROJEKTIM PER RRUGE DHE UJESJELLESA”
BASHKIA LIBRAZHD

Viti 2022

DETYRE PROJEKTIMI PER REALIZIMIN E STUDIM PROJEKTIMIT PER OBJEKTET:

- 1. “Rikonstruksioni i rruges fshati Vulcan ” (Nj.A Hotolisht) L=2900ml**
- 2. Ndertimi i ujesjellesit te fshatit Vehçan (Nj.A Hotolisht)**
- 3. Rikonstruksioni i rruges Polis-Qender Gurshpate loti II ” L=4000ml**

Bashkia Librazhd , me fond 7,000,000 lekë (me TVSH) te miratuar ne Keshillin e Bashkise ne Buxhetin e vitit 2022 kërkon të realizojë studim projektimit për objektet: “Rikonstruksioni i rruges fshati Vulcan ” (Nj.A Hotolisht) L=2900ml, ”Ndertimi i ujesjellesit te fshatit Vehçan (Nj.A Hotolisht) , “Rikonstruksioni i rruges Polis-Qender Gurshpate loti II (Nj.A Polis), L=4000ml, vlere paraprake e investimit eshte 305,398,971 leke pa tvsh.

I. Rikonstruksioni i rruges fshati Vulcan ” (Nj.A Hotolisht) L=2900ml

1. Të dhëna dhe kërkesa të përgjithëshme

Kjo rruge ka nje gjatesi prej 2900 ml qe fillon nga rruga nacionale Elbasan – Librazhd (nenkalimi i hekurudhes) deri tek degezimi per ne fshatin Buzgare. Ndertimi i kesaj rruge parashikon perfitues te drejteperdrejte nje komunitet prej 850 banore. Ndertimi i rruges do te ndikojë ne menyre te drejtperdrejte ne rritjen e cilesise se jeteses dhe krijimin e mundesive per zhvillimin e agroturizmit ne zone.

Gjëndja e infrastrukturës në këtë objekt paraqitet:

a) Infrastruktura rrugore

Aktualisht trupi i rruges ka nje gjeresi qe varion 2.5m deri ne 4 m e cila kerkon zgjerim ne gjithe gjatesine e saj si dhe vendosjen e shtresave rrugoresipas parametrave teknike te ndertimit te rrugeve. Kjo rruge do te kete nje gjeresi asfaltit prej 3.5m, me bankina ne te dy krahet me nga 0.5m dhe kanal anesor te veshur me beton sipas rastit. Te gjitha shtresat dhe nenshtresat si dhe ndertimi i te gjitha veprave te artit (ndertimin e mureve mbajtes, prites, kanalit anesor, tombino betoni etj). Disiplinimi i ujerave atmosferike eshte nje kerkese dhe domosdoshmeri qe duhet te zgjedhe projekti.

b) Kanalizimet e ujrave të zeza

Nuk ka nje kerkese specifike per disiplinimin e ujrave te zeza

c) Kanalizimet e ujrave të bardha

Nuk ka një rrjet ekzistues të Ujërave të Bardha por qe te gjitha keto ujera ne varesi te terrenit do te disjplinohen me kanale, tubacione dhe puseta.

d) Rrjeti ujësjellësit

Nuk ka nje kerkese specifike per rrjetin e ujesjellesit.

e) Rrjeti ndriçimit rrugor

Nuk ekziston ndriçimi rrugor.

2. Kërkesat e projektit

Nuk ka kerkese specifike pasi aksi i rruges eshte pothuajse i percaktuar dhe nuk do te kete devijime te medha , do te ruhen kerkesat specifike per kufinjte e lejuar te pjerresise se rruges.

a) Rrugët

Rruga të trajohet sipas gjerësisë të trupit të rrugës të përcaktuar në Planin Rregullues. Shtresat rrugore dhe të trotuarëve të trajtohen të tilla që të sigurojnë garanci, qëndrueshmëri dhe të përballojnë kapacitetet faktike dhe të prespektivës.

Materialet që do të përdoren, të jenë sipas kushteve teknike te Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve.

Në përfundim mund të thuhet se projektuesi duhet të konsultohet vazhdimisht me Bashkinë përpara fillimit të punës për projektin, ashtu si edhe gjatë të gjitha fazave të projektimit dhe zbatimit të tij dhe kjo si për garantimin e saktësisë së bazës së të dhënave ashtu edhe për reflektimin e ndryshimeve të pritshme nga plan/studimet e përmendura më sipër.

Përveç saktësisë së të dhënave si më sipër, projektuesi përpara se të fillojë punën me projektimin duhet që paraprakisht:

1. Të bëjë relievin (azhornimin) e rruges; të jepet plani i piketimit (me pikat e forta etj);
2. Të marrë të gjitha azhornimet e rrjetit të infrastrukturës, etj ;
3. Projektuesi duhet të bëjë verifikimin paraprak në terren dhe sondime për saktësinë e të dhënave/azhornimeve, për rrjetin e infrastrukturës, përpara fillimit të projektimit. Kjo duhet në menyre që të evitohen pasaktësite gjatë projektimit dhe zbatimit, si rezultat i të

dhënavë të marra që nuk përputhen me gjendjen në terren;

b) Skema e rrjetit rrugor

Projektuesi duhet të paraqesë mënyrat e aksesit dhe të qarkullimit në rrugë dhe lidhjet me rrjetin ekzistues rrugor të zonës.

c) Sinjalistia

Sinjalistika do të përfshijë sinjalistikën vertikale dhe horizontale. Pranë kryqëzimeve të vendosen shtylla njoftuese për secilën rrugë sipas senseve të orientimit përkatës.

3. Fazat e zbatimit

Për efekt të fondit të zbatimit, të realizimit të prishjeve (të mundshme) si dhe të efikasitetit të ndërhyrjes në këtë segment rrugor, Projektuesi duhet t'i rekomandojë Investitorit fazat e realizimit në kohë (ose sipas elementëve të ndryshëm) të Projektit.

Pra Projektuesi mund t'i rekomandojë Investitorit që projekti të realizohet në disa faza ose lote, si dhe sipas elementëve të ndryshëm të tij (psh. rrjetit rrugor dhe infrastruktura/punime ndërtimi, apo mobilimi urban/furnizim, vendosje).

4. Hartimi i Preventivit

Në hartimin e preventivit, vec të tjerave, do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizmin e zbatimit me faza, çmimet e referencës do të jenë sipas akteve ligjore në fuqi, dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të paraqitet sipas Formatit/Modelit të rekomanduar nga Bashkia.

5. Standartet

Standarte në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislativi në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe

limitimet për financimin e veprës.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për personat me aftësi të kufizuara, të verbërit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastruktures për këtë kategori, të jepen nga Projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

Standarte në paraqitjen e dokumentacionit Teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, Projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihen parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për urbanistikën”, Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislacioni në fuqi.

6. Realizimi i Projektit

6.1 Faza e V (Projekti i zbatimit)

Projekti i zbatimit duhet të përmbajë:

1. Raportin Teknik
2. Hartimi i relievit topografik të rrugës (kordinata lokale, kuota absolute)
3. Projektin e zbatimit të trases së rrugës.
4. Kuotat e pushtave ekzistuese (koka e tubit, diametri i tubit)
5. Profilin gjatësor të rrugës.
6. Profilat tërthorë të rrugës
7. Profilat tip të seksionit tërthor të rrugës
8. Detajet e ndryshme të trotuarit, bordurave etj
9. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujrave të shiut.
10. Projektin e sistemit të ndriçimit.
11. Sinjalizimin vertikal dhe horizontal.
12. Specifikimet Teknike.
13. Grafiku i punimeve.
14. Licensë të firmës projektuese, dhe ekstrakt i regjistrit tregtarë.

6.2 Faza e VI (Preventivi perfundimtar)

Në hartimin e preventivit, çmimet e referencës do të jenë sipas akteve ligjore në fuqi, dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të paraqitet sipas Formatit/Modelit të rekomanduar nga Bashkia.

Rekomandime për projektuesin

- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin egzistues lidhur me segmentet rrugore.
- Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia Librazhd, seksioni i Urbanistikës dhe nga Kadastra. Në hartimin e projektit duhet të kihet parasysh edhe standarte të ndryshme që ka nxjerrë Bashkia Librazhd siç janë p.sh. tipi i kollonave të ndriçimit, llojet e ndriçuesve e të tjera të kësaj natyre.
- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standartin e kërkuar.

Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar

Projekti do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë Librazhd.

Raportimi

I gjithë dokumentacioni do të paraqitet në 3 (tre) kopje origjinale, në version të dixhitalizuar ku vizatimet të jenë në File AUTOCAD dhe Adobe PDF ndërsa dokumentacioni tjetër nga programet e Microsoft Office si Word, Excel, etj. dhe në 2 (dy) CD.



Fig. 1 Gjurma e segmentit rrugor fshati Vulcan

II. Ndertimi i ujesjellesit te fshatit Vehçan (Nj.A Hotolisht)

1. Të dhëna dhe kërkesa të përgjithëshme

Zona ne studim perfshin fshatin Vehcan me rreth 1800 banore, ku ndodhet nje qender shendetesore, nje ambulanca, nje shkolla 9-vjecare dhe fillore me rreth 60 nxenes.

Aktualisht banoret e ketij fshati furnizohen me uje nga burime ujore te marra privatisht por qe cilesia e ujit qe ata perdorin eshte e pa certifikuar nga institucionet perkatese.

Zona ne studim ka shtrirje gjeografike te madhe per shkak te terrenit kodrinor e fushor dhe largesise se lagjeve nga njera-tjetra.

Ndertimi i ujesjellesit do te ndikojte ne permiresimin e kushteve higjeno-sanitare te banoreve te kesaj zone. Ky projekt do te beje te mundur shperndarjen per cdo lagje dhe menaxhimin e rregullt te ujesjellesit.




Fig. 2 Zona ne studim

2. Objektivi:

Objekti i detyrës së projektimit është hartimi i projektit të ndertimit të ujesjellesit për fshatin Vehçan i cili duhet të përfshijë:

1. Ndertimin e kaptazhit (Vepra e marrjes).
2. Ndertimin e rrjetit të jashtëm
3. Ndertimin e një ose disa depove bazuar në shpërndarjen gjeografike të zonës në studim.
4. Ndërtimin e rrjetit shpërndarës ku do të përfshihet edhe pajisja me kasete shpërndarje individuale për konsumatorët me të gjithë elementet e nevojshëm përfshi dhe matës të ujit.

3. Qëllimi i punës:

Qëllimi i këtij shërbimi është kryerja e Studim-Projektimit të furnizimit me ujë dhe të gjithë komponentet përbërës të këtij furnizimi duke përfshirë burimet, kaptazhet, rezervuarët, linjën e transmetimit, rrjetin e shpërndarjes dhe lidhjet e shtëpive për zonat e përzgjedhura.

Për realizimin e projektit, projektuesi duhet të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me projektin që duhet të hartojë për furnizimin me ujë sipas detyrës së projektimit dhe të konsultohet me Bashkinë Librazhd dhe SH.A, Ujesjellesin, KESH e Telekomin.

Cilesia e studimit të projektimit duhet të jetë e tillë që të arrihet standarti i kërkuar që të plotësojë kushtet e projektimit.

3.1 Rezultatet e pritëshme

- ✓ Mbulimi i plotë me rrjet të ujësjesit për të furnizuar me ujë të gjitha zonat ku mungon kjo infrastrukturë dhe duke plotësuar nevojat për ujë të lokaliteteve me rëndësi turistike.
- ✓ Rikonstruksioni dhe zëvendësimi i rrjetit të ujësjesit në gjendje të amortizuar, përfshirë pusetat e manovrimit, të reduktoreve të presionit, të ajrimit dhe kasetat e matësve individuale.
- ✓ Treguesit për matjen e suksesit të programit është lidhja 100% e popullatës që jeton në zonën e furnizimit (Rezultati i drejtpërdrejtë) dhe standardet e vazhdueshme (24h/d indirekt/afatgjatë).
- ✓ Masat përfshijnë rehabilitimin dhe ndërtimin e sistemeve të furnizimit me ujë.

4. Te dhenat e projektit

Te dhenat dhe kërkesat e detyrës së projektimit:

→ Popullsia është 1800 banorë

- Prespektiva e ujesjellesit te parashikohet per 25 vjet.
- Shtesa natyrale e popullise te merret 2,0%
- Nevojat per uje per banore (150 l/dite/banore).
- Humbjet ne rrjetin shperndares te furnizimit me uje llogariten 20%.
- Materiali i tubacionit te jete celik ose HDPE i çertifikuar (PE / RC).

5. Standartet

Standarte ne projektim

Projekti do te hartohet ne perputhje me te gjitha normat dhe standartet per projektim qe parashikon legjislacioni ne fuqi. Projekti duhet te siguroje respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjate zbatimit. Eshte pergjegjesi e projektuesit saktesia dhe respektimi i te gjitha standarteve dhe normave perkatese.

Projektuesi mund te rekomandoje edhe prezantimin e standareve te reja, per parafrimin me normat e BE-se, si dhe te praktikave me te mira nderkombetare ne projektim dhe zbatim.

Projektuesi duhet te shqyrtoj vizatimet dhe dokumentet e vena dispozicion te tij nga njesia e geverisjes vendore dhe do te inspektoj vendin e projektit dhe rrethinat e tij .

Standarte ne paraqitjen e dokumentacionit teknik

Rekomandime per projektuesin:

- Projektuesi duhet te perdore dhe te rishikojte te gjithe informacionin ekzistues lidhur me gjendjen ekzistuese te objektit ne fjale.
- Projektuesi duhet te perdore studimet dhe te dhenat paraprake qe disponohen nga Bashkia Librazhd.
- Cilesia e studimit duhet te jete e tille qe te arrihet standardi i kerkuar.
- Projektuesi te perdore programet e kerkuara kompjuterike, si dhe te nxitet perdorimi i programeve te reja, me te avancuara te fushes.

6. Realizimi i projektit

6.1 Fazat e projektimit per kete objekt sipas VKM nr. 354 date 11.05.2016 jane:

- Faza V - Projekti i Zbatimit
- Faza VI- Preventivi Perfundimtar

6.2 Detyrat e detajuara sipas fazave

1. FAZA V- Projektet e zbatimit

Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim.

i. Shërbimet bazë

a) Përpunimi i rezultateve të fazave të punimeve 3 dhe 4 (përgatitja hap pas hapi e zgjidhjes dhe e paraqitjes së saj) duke pasur parasysh të gjitha kërkesat specifike të fushës dhe duke përdorur kontributet e pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, deri në zgjidhjen e aftë për zbatim.

b) Paraqitje vizatimore dhe llogaritëse e objektit me të gjitha të dhënat e veçanta të nevojshme për zbatimin, përfshirë vizatime të detajuara në shkallët e kërkuara.

c) Përpunimi i bazave për të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, dhe integrimi i kontributeve të tyre deri në zgjidhjen e aftë për zbatim

ç) Vazhdimi i planifikimit të zbatimit gjatë ndërtimit të objektit

ii. Shërbimet e veçanta

d) Hartimi grafikut të punimeve dhe i planeve të rrjetit të infrastrukturës

2. FAZA VI-Preventivat përfundimtar

Llogaritja e sasive, përgatitja e analizave të çmimeve dhe hartimi i dokumentave të tenderit.

i. Shërbimet bazë:

a) Llogaritja e sasive dhe renditja e pozicioneve të veçanta duke përfshirë kontributin e pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim;

b) Hartimi i dokumenteve të dhënies, në mënyrë të veçantë i përshkrimeve të punëve me listën e punëve si dhe të kushteve të veçanta kontraktuale;

c) Akordimi dhe koordinimi i dokumenteve të dhënies me pjesëmarrësit e tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim;

ç) Përcaktimi i fazave kryesore të zbatimit;

d) Çmimet e preventivit të hartohet sipas VKM në fuqi

6.3 Kerkesat qe duhet te plotesoje projekti

1. Koorografine ne shkalle 1:10000.

2. Hartimin e relievit topografik te zones ku do te nderhyhet (kordinata lokale, kuota absolute).

3. Planimetria e linjave te transmetimit dhe rrjeteve shperndares ne shkalle 1:1000.

4. Profilat gjatesore per linjen e jashtme ne shkallen H 1:2000; V 1:1000 te shoqeruar me te dhenat hidraulike si \emptyset mm, q=lit/sek, v=m/sek, i=m/m.
5. Profila terthore ne shkalle 1:20.
6. Planimetri, prerje te kaptazheve ne shkalle 1:50; 1:100.
7. Detaje te ndryshme ne shkalle 1:50.
8. Planimetri, prerje, detaje te ndertimit te rezervuareve.
9. Planimetri, prerje, detaje te pusetave te komandimit ne shkalle 1:50; 1:100.
10. Planimetri, prerje, detaje te pusetave te reduktimit te presionit ne shkalle 1:50; 1:100.
11. Relacioni teknik per zgjedhjen e dhene sipas detyres se projektimit.
12. Skema hidraulike.
13. Llogaritjet hidraulike.
14. Llogaritjet konstruktive.
15. Preventivin e punimeve.
16. Specifikimet teknike.
17. Raport hidrologjik.

Raportimi

I gjithe projekti do te paraqitet ne 3 kopje te printuara;

- ne format A3 Paraqitja grafike e projektit
- ne format A4 relacioni teknik, llogaritjet, specifikimet teknike, grafiku i punimeve dhe preventivi me çmime dhe pa çmime.

Gjithashtu i gjithe projekti do te dorezohet ne 2 kopje CD ne versionin te dixhitalizuar (1 CD me filet e punuar dhe 1 CD me gjithe dokumentacionin e kthyer ne format PDF).

III. Rikonstruksioni i rruges Polis-Qender Gurshpate loti II (Nj.A Polis), L=4000ml

1. Të dhëna dhe kërkesa të përgjithëshme

Kjo rrugë ka një gjatësi prej 4000 m që fillon nga perfundimi i lotit I të investuar nga Fondi Shqiptar I Zhvillimit dhe vazhdon në drejtim të fshatit Gurshpat. Ndertimi i kësaj rruge parashikon përfitues të drejteperdrejte një komunitet prej 2500 banorë. Ndertimi i rruges do të ndikojë në mënyrë të drejteperdrejte në rritjen e cilësisë së jetesës dhe krijimin e mundësive për zhvillimin e agroturizmit në zonë.

Gjendja e infrastrukturës në këtë objekt paraqitet:

a) Infrastruktura rrugore

Aktualisht trupi i rruges ka një gjatësi që varion 3.5m deri në 5 m e cila kërkon zgjerim në gjithë gjatësinë e saj si dhe vendosjen e shtresave rrugore sipas parametrave teknike të ndertimit të rrugëve. Kjo rrugë do të ketë një gjatësi asfaltit prej 3.5m, me bankina në të dy krahet me nga 0.5m dhe kanal anesor të veshur me beton sipas rastit. Të gjitha shtresat dhe nënshtresat si dhe ndertimi i të gjitha veprave të artit (ndertimin e mureve mbajtës, prites, kanalit anesor, tombino betoni etj).

Disiplinimi i ujërave atmosferike është një kërkesë dhe domosdoshmeri që duhet të zgjedhe projekti.

b) Kanalizimet e ujërave të zeza

Nuk ka një kërkesë specifike për disiplinimin e ujërave të zeza

c) Kanalizimet e ujërave të bardha

Nuk ka një rrjet ekzistues të Ujërave të Bardha por që të gjitha këto ujëra në varesi të terrenit do të disiplinohen me kanale, tubacione dhe puseta.

d) Rrjeti ujësjellës

Ekziston rrjeti i ujësjellësit.

e) Rrjeti ndriçimit rrugor

Nuk ekziston ndriçimi rrugor.

2. Kërkesat e projektit

Nuk ka kërkesë specifike pasi aksi i rruges është pothuajse i përcaktuar dhe nuk do të ketë devijime të mëdha, do të ruhen kërkesat specifike për kufinjte e lejuar të përrresisë së

rruges.

d) Rrugët

Rruga të trajohet sipas gjerësisë të trupit të rrugës të përcaktuar në Planin Rregullues. Shtresat rrugore dhe të trotuarëve të trajtohen të tilla që të sigurojnë garanci, qëndrueshmëri dhe të përballojnë kapacitetet faktike dhe të prespektivës.

Materialet që do të përdoren, të jenë sipas kushteve teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të

Rrugëve.

Në përfundim mund të thuhet se projektuesi duhet të konsultohet vazhdimisht me Bashkinë përpara fillimit të punës për projektin, ashtu si edhe gjatë të gjitha fazave të projektimit dhe zbatimit të tij dhe kjo si për garantimin e saktësisë së bazës së të dhënave ashtu edhe për reflektimin e ndryshimeve të pritshme nga plan/studimet e përmendura më sipër.

Përveç saktësisë së të dhënave si më sipër, projektuesi përpara se të fillojë punën me projektimin duhet që paraprakisht:

1. Të bëjë relievin (azhornimin) e rruges; të jepet plani i piketimit (me pikat e forta etj);
2. Të marrë të gjitha azhornimet e rrjetit të infrastrukturës, etj;
3. Projektuesi duhet të bëjë verifikimin paraprak në terren dhe sondime për saktësinë e të dhënave/axhornimeve, për rrjetin e infrastrukturës, përpara fillimit të projektimit. Kjo duhet në mënyrë që të evitohen pasaktësitë gjatë projektimit dhe zbatimit, si rezultat i të dhënave të marra që nuk përputhen me gjendjen në terren;

e) Skema e rrjetit rrugor

Projektuesi duhet të paraqesë mënyrat e aksesit dhe të qarkullimit në rrugë dhe lidhjet me rrjetin ekzistues rrugor të zonës.

f) Sinjalistia

Sinjalistika do të përfshijë sinjalistikën vertikale dhe horizontale. Pranë kryqëzimeve të vendosen shtylla njoftuese për secilën rrugë sipas senseve të orientimit përkatës.

3. Fazat e zbatimit

Për efekt të fondit të zbatimit, të realizimit të prishjeve (të mundshme) si dhe të efikasitetit të ndërhyrjes në këto segmente rrugor, Projektuesi duhet t'i rekomandojë Investitorit fazat e realizimit në kohë (ose sipas elementëve të ndryshëm) të Projektit.

Pra Projektuesi mund t'i rekomandojë Investitorit që projekti të realizohet në disa faza ose lote, si dhe sipas elementëve të ndryshëm të tij (psh. rrjetit rrugor dhe infrastruktura/punime ndërtimi, apo mobilimi urban/furnizim, vendosje).

4. Hartimi i Preventivit

Në hartimin e preventivit, vec të tjerave, do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizmin e zbatimit me faza, çmimet e referencës do të jene sipas akteve ligjore në fuqi, dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efijencën e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të paraqitet sipas Formatit/Modelit të rekomanduar nga Bashkia.

5. Standartet

Standarte në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standareve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për personat me aftësi të kufizuar, të verbërit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastruktures për këtë kategori, të jepen nga Projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, Projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihen parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për urbanistikën”, Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislacioni në fuqi.

6. Realizimi i Projektit

6.1 Faza e V (Projekti i zbatimit)

Projekti i zbatimit duhet të përmbajë:

1. Raportin Teknik
2. Hartimi i relievit topografik të rrugës (kordinata lokale, kuota absolute)
3. Projektin e zbatimit të trases së rrugës.
4. Kuotat e pushtave ekzistuese (koka e tubit, diametri i tubit)
5. Profilin gjatësor të rrugës.
6. Profilat tërthorë të rrugës
7. Profilat tip të seksionit tërthor të rrugës
8. Detajet e ndryshme të trotuarit, bordurave etj
9. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujrave të shiut.
10. Projektin e sistemit të ndriçimit.
11. Sinjalizimin vertikal dhe horizontal.
12. Specifikimet Teknike.
13. Grafiku i punimeve.
14. Licensë të firmës projektuese, dhe ekstrakt i regjistrit tregtarë.

6.2 Faza e VI (Preventivi perfundimtar)

Në hartimin e preventivit, çmimet e referencës do të jenë sipas akteve ligjore në fuqi, dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të paraqitet sipas Formatit/Modelit të rekomanduar nga Bashkia.

Rekomandime për projektuesin

- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin egzistues lidhur me segmentet rrugore.
- Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia Librazhd, seksioni i Urbanistikës dhe nga Kadastra. Në hartimin e projektit duhet të kihet parasysh edhe standarte të ndryshme që ka nxjerrë Bashkia Librazhd siç janë p.sh. tipi i kollonave të ndriçimit, llojet e ndriçuesve e të tjera të kësaj natyre.
- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standartin e kërkuar.

Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar

Projekti do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë Librazhd.

Raportimi

I gjithë dokumentacioni do të paraqitet në 3 (tre) kopje origjinale, në version të dixhitalizuar ku vizatimet të jenë në File AUTOCAD dhe Adobe PDF ndërsa dokumentacioni tjetër nga programet e Microsoft Office si Word, Excel, etj. dhe në 2 (dy) CD.



Fig. 3 Gjurma e segmentit rrugor Polis-Qender Gurshpate loti II

GRUPI I PUNES: